



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_. 2020

“PËR  
SHTRIRJEN, STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN, METODOLOGJINË  
E PËRGATITJES DHE PROCEDURËN E DISKUTIMIT PUBLIK TË  
PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË  
PALUAJTSHME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3, të nenit 46 të ligjit nr. 27/2018, datë 17/05/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Plani i menaxhimit i pasurisë kulturore është dokumenti bazë për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të pasurisë kulturore të paluajtshme.
2. Plani i menaxhimit ka për qëllim planifikimin, bashkërendimin e kompetencave të aktorëve që veprojnë në pasurinë kulturore, si dhe minimizimin e rreziqeve për vlerën kulturore, optimizimin dhe gëzimin e saj duke ofruar kushte për akses, informim, ruajtje dhe mbrojtje.
3. Planet e menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme hartohen me qëllim:
  - a) propozimin e një modeli efektiv dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e pasurisë kulturore;
  - b) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe udhëzimeve për menaxhimin e vlerave kulturore bazuar në praktikën më të mira të fushës;

- c) mbrojtjen e pasurisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
  - d) administrimin efektiv të burimeve financiare;
  - e) përcaktimin e një strukture administrative funksionale me staf të kualifikuar për menaxhimin e pasurisë kulturore.
4. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe/ose në bashkëpunim me institucionet e specializuara harton planet e menaxhimit, proces që drejtohet dhe bashkërendohet nga Instituti Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore (IKTK) në përputhje me legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe këtë vendim.
  5. Plani i menaxhimit hartohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me propozim/kërkesë nga partner/investitorë/donorë, pasi partneri/investitori/donatori është dakordësuar më parë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.
  6. Për pasuritë kulturore të paluajtshme, në pronësi të subjekteve private, apo në administrim të njësisë së vetëqverisjes vendor, iniciativa për përgatitjen e planit të menaxhimit i takon këtyre të fundit, të cilët e përcjellin në strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për kulturën.
  7. Në çdo rast, procesi i përgatitjes së draftit të planit të menaxhimit koordinohet dhe monitorohet nga IKTK-ja.

## II. SHTRIRJA E PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Plani i menaxhimit konsiston në bashkërendimin në mënyrë efikase të burimeve të pasurisë kulturore në shërbim të përmbushjes së objektivave të planit për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.
2. Kohëzgjatja e planit të menaxhimit përcaktohet në varësi të objektivave që kërkohen të arrihen nëpërmjet tij. Në çdo rast, kohëzgjatja e një plani menaxhimi nuk mund të jetë më pak se 5 vjet.
3. Plani i menaxhimit parashikon përmbushje të objektivave që ndahen në:
  - a) objektiva afatshkurtër;
  - b) objektiva afatmesëm;
  - c) objektiva afatgjatë.

## III. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PASURISË KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Struktura e planit të menaxhimit përmban, por pa u kufizuar, sa më poshtë vijon:
  - a) përmbledhjen ekzekutive;
  - b) hyrjen;
  - c) përshkrimin e pasurisë kulturore;
  - d) vlerësimin e vlerave të pasurisë;
  - e) aspekte të tjera të lidhura me pasurinë;
  - f) vizionin, qëllimin dhe objektivat;
  - g) administrimin e pasurisë kulturore;
  - h) planin e veprimit;
  - i) zbatimin dhe monitorimin;
  - j) shtojcat.
  
2. Përmbajtja e planit të menaxhimit trajton, por pa u kufizuar, çështjet si më poshtë vijon:
  - a) përmbledhjen ekzekutive, në të cilën paraqitet shkurtimisht vizioni, qëllimi i planit të menaxhimit, objektivat, përmbajtja, si dhe propozimet dhe aktivitetet kryesore që parashikohen të kryhen për periudhën kohore të vlefshmërisë së planit;
  - b) hyrjen, në të cilën paraqitet shkurtimisht nevoja për planin e ri të menaxhimit, metodologjia e përgatitjes, konsultimet e kryera me palët e interesuara, praktikat më të mira, analiza e legjislacionit në fuqi;
  - c) përshkrimin e hollësishëm të pasurisë kulturore, vlerat, gjendja e konservimit të tyre, karakteristikat, integriteti, autenticiteti, kufijtë, koordinatat gjeografike, të dhëna hartografike, të dhëna vizuale (fotografi ose skica), statusi ligjor që mbron pasurinë kulturore, çështje që lidhen me administrimin dhe udhëzime për adresimin e tyre;
  - d) vlerësimin e vlerave kulturore, vlerave të jashtëzakonshme universale (nëse pasuria është pjesë e listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s), vlerave të tjera të natyrave të ndryshme nga ajo kulturore, masat ruajtëse dhe mbrojtëse në funksion të vlerave;
  - e) aspekte të tjera të lidhura me pasurinë, si aspekte të zhvillimit social-ekonomik të komunitetit në dhe përreth pasurisë, turizmin, infrastrukturën dhe çështje të tjera të lidhura me pasurinë;
  - f) vizionin, ku parashtrohet në mënyrë të përmbledhur ruajtja dhe zhvillimi i pasurisë për një periudhë më të gjatë se afati i planit të menaxhimit në raport me strategjitë kombëtare, qëllimin dhe objektivat;
  - g) administrimin, ku analizohen në mënyrë të detajuar modelet e mundshme për menaxhimin sa më efikas të pasurisë kulturore të paluajtshme, duke propozuar alternativa zgjidhjeje, ndryshime dhe përmirësime të nevojshme në modelin aktual të administrimit në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së autenticitetit dhe integritetit të vlerave kulturore;

- h) planin e veprimt, në të cilin paraqiten të gjitha masat dhe veprimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata që duhet të ndërmerren për përmbushjen e objektivave specifike të planit të menaxhimit, si dhe përdorimin efikas të pasurisë kulturore të paluajtshme;
- i) zbatimin dhe monitorimin, në të cilin përfshihen masat dhe indikatorët për monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit dhe përmbushjes së objektivave të tij;
- j) shtojcat, në të cilat përfshihen dokumente plotësuese apo mbështetëse që lidhen me pasurinë kulturore të paluajtshme, si harta, akte ligjore dhe nënligjore në fuqi, plani i biznesit, plani i konservimit, dokumente të tjera, sipas rastit.

#### IV. METODOLOGJIA E PËRGATITJES SË PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Metodologjia për përgatitjen e planit të menaxhimit për pasuritë kulturore të paluajtshme—synon unifikimin e hapave që kalon përgatitja e planit të menaxhimit, e cila përfshin, por pa u kufizuar, elementët e mëposhtëm:

- a) analizën e integruar të pasurisë kulturore të paluajtshme, e cila përmban:
  - i. të dhënat e terrenit;
  - ii. analizën e vlerave kulturore, rëndësisë, integritetit, autenticitetit dhe të gjendjes së konservimit;
  - iii. analizën e vlerave të tjera të integruara me vlerat kulturore;
  - iv. analizën e kuadrit ligjor dhe institucional;
  - v. analizën e pikave të forta, dobësitë, mundësitë, kërcënimet e faktorëve që ndikojnë në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetin e vlerave.
- b) hartimin e vizionit, i cili përmban:
  - i. investimin në ruajtjen e vlerave kulturore në funksion të mbrojtjes së integritetit, autenticitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve;
  - ii. modelin e administrimit të qenësishëm dhe funksional;
  - iii. bashkëpunimin institucional dhe ndërinstitutional efektiv;
  - iv. rritjen e kapaciteteve për të gjeneruar të ardhura dhe për të rritur fuqinë përthithëse të fondeve;
- c) planifikimin strategjik, i cili përmban:
  - i. përcaktimin e objektivave për mbrojtjen e vlerave kulturore dhe sigurimin e përfitimeve për shoqërinë, që duhet të jenë “të zgjuara”, specifike, të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe të përcaktuara nga afate kohore;

- ii. rezultatet e pritshme dhe treguesit mbi bazën e të cilave do të matet suksesi ose dështimi i zbatimit të planit të menaxhimit;
- d) planin e veprimit, i cili përmban:
- i. aktivitetet specifike për realizimin e objektivave;
  - ii. rezultatet e matshme në terma konkretë duke përcaktuar buxhetin;
  - iii. institucionet përgjegjës për zbatimin, afatet kohore dhe burimet e nevojshme për realizimin.
- e) monitorimin dhe rishikimin e planit të menaxhimit, e cila përmban:
- i. monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit;
  - ii. indikatorët dhe planet e veprimit të përcaktuar në planin e menaxhimit.
2. Plani i menaxhimit, në varësi të specifikës së pasurisë kulturore të paluajtshme, hartohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me mbështetjen e:
- a) institucioneve shtetërore të specializuara;
  - b) subjekteve të kontraktuara nga institucionet shtetërore të specializuara;
  - c) subjekteve të kontraktuara nga partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm.

## V. KONSULTIMI PUBLIK

1. Drafti i planit të menaxhimit është objekt i konsultimeve publike me institucione qendrore dhe vendore, grupe interesi të identifikuara dhe partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm.
2. Konsultimi publik i draftit të planit të menaxhimit bëhet me grupe të ndryshme interesi në të cilët duhet të përfshihen, por pa u kufizuar, sa më poshtë vijon:
  - a) subjektet e përfshira në sistemin primar të menaxhimit të pasurisë kulturore (institucionet që kanë në pronësi dhe/ose administrojnë pasuritë kulturore);
  - b) pronarë të ligjshëm, të njohur brenda pasurisë kulturore;
  - c) strukturat shtetërore/subjektet që janë burime dytësore për menaxhimin e pasurisë kulturore (p.sh. këshillat vendor kompetentë për menaxhimin e zonës së mbrojtur);
  - d) komuniteti i zonës dhe grupe të tjera të interesuara (biznese, organizata jofitimprurëse apo donatorë të mundshëm, administrata rajonale e zonave të mbrojtura në rastet kur pasuria kulturore gjendet në zonë të mbrojtur mjedisore dhe struktura përgjegjëse për

pyjet dhe kullotat në bashki kur pasuria gjendet në fondin pyjor dhe kullosor).

3. Fazat e diskutimit publik të draftit të planit të menaxhimit përfshijnë:
  - a) publikimin e draft-planit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
  - b) diskutimin publik të draft-planit të menaxhimit;
4. Publikimi i draft-planit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, përfshin procedurat e mëposhtme:
  - a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore publikon në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore draft-planin e menaxhimit;
  - b) palët e interesuara kanë të drejtë të dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mendimet dhe rekomandimet e tyre rreth projektit të paraqitur brenda 20 ditëve pune nga publikimi;
  - c) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore shqyrton dhe vendos mbi mendimet dhe rekomandimet e paraqitura;
  - d) plani i menaxhimit shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe nëse nuk janë pranuar, një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre;
  - e) në rastin e pasurive me rëndësi universale, draft-planin e menaxhimit i dërgohet për mendim edhe UNESCO-s.
5. Gjatë periudhës së publikimit sipas pikës 4 të këtij kreu, draft-planin e menaxhimit i nënshtrohet diskutimit publik sipas procedurave të mëposhtme:
  - a) ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore i njofton draft-planin e menaxhimit të pasurisë kulturore Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) dhe institucioneve kompetente përkatëse, njësisë së vetëqeverisjes vendore të zonës ku do të zhvillohet plani, si dhe grupeve e palëve të interesuara;
  - b) DRTK-ja dhe/ose institucionet kompetente përkatëse, që kanë në administrim pasurinë kulturore të paluajtshme, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet pasuria, cakton datën e zhvillimit të diskutimit publik dhe njofton grupet apo palët e interesuara dhe komunitetin nëpërmjet afishimit të njoftimit në zonën që preket nga plani;
  - c) në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik përcaktohen afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara

paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre, si dhe referenca në faqen zyrtare të internetit të ministrisë ku është publikuar projekt-plani i menaxhimit. Njoftimi publikohet edhe në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

- d) gjatë zhvillimit të takimit përfaqësuesi i DRTK-së ose i institucionit kompetent përkatës mban procesverbal, në të cilin pasqyrohen të gjitha diskutimet, mendimet dhe rekomandimet e paraqitura. Listë-prezenca firmoset nga të gjithë të pranishmit dhe i bashkëlidhet procesverbalit përkatës.
- e) mendimet ose rekomandimet, listë-prezenca dhe një kopje e procesverbalit i përcillen ministrisë ose IKTK-së;
- f) në përfundim të procesit ministria ose IKTK-ja harton një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara dhe, në rast të refuzimit të tyre, një përmbledhje të arsyeve të refuzimit.

6. Pas përfundimit të diskutimit publik të draft-planit të menaxhimit, vijohet me miratimin e tij sipas parashikimeve të nenit 47, të ligjit 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

## VI. DISPOZITAT E FUNDIT

Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe të gjithë institucionet publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

RELACION

“PËR  
SHTRIRJEN, STRUKTURËN, PËRMBAJTJEN, METODOLOGJINË E  
PËRGATITJES DHE PROCEDURËN E DISKUTIMIT PUBLIK TË  
PLANEVE TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE TË  
PALUAJTSHME”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi hartohet në funksion të menaxhimit efektiv dhe të qëndrueshëm të pasurisë kulturore të paluajtshme, për të minimizuar rreziqet për vlerat kulturore, duke ofruar kushte për akses, informim, ruajtje dhe mbrojtje. Planet e menaxhimit kanë për qëllim të sigurojnë qasjen e një modeli efektiv dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e pasurisë kulturore të paluajtshme, duke zbatuar udhëzimet dhe politikat për menaxhimin e vlerave kulturore, mirëadministrimin e burimeve financiare, nëpërmjet një strukture organizative funksionale.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME  
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME  
PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË  
TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik, të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme” është hartuar në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare për reformën ligjore në trashëgiminë kulturore, i cili nisi me miratimin e ligjit 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”. Në vijim të miratimit të ligjit, projekt-akti që po sjellim për shqyrtim dhe miratim, është i parashikuar në Planin e Përgjithshëm Analitik të Projekt-akteve të vitit 2019 për Ministrinë e Kulturës, të miratuar me vendimin nr. 764, datë 27.12.2018 të Këshillit të Ministrave.



Ministria e Kulturës është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 17.5.2018 ka miratuar ligjin nr. 27/2018 "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", i cili ka hyrë në fuqi më datë 27.06.2018.

Ky ligj, në nenin 45 dhe 46 të tij, parashikon hartimin e planeve të menaxhimit për vlerat e paluajtshme kulturore të përfshira në inventarin e Trashëgimisë Kulturore të Republikës së Shqipërisë. Hartimi i planit të menaxhimit synon një model efektiv dhe të qëndrueshëm me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, në përputhje me regjimet e saj të mbrojtjes.

### IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ky projektvendim është hartuar mbështetur në nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 46, të ligjit nr. 27/2018, "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*". Për sa i përket çështjes së kushtetutshmërisë së projektvendimit, nga pikëpamja formale ai përbën një akt nënligjor të nxjerrë në respektim të kriterëve të parashikuara nga neni 118 i Kushtetutës.

### V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është i përbërë nga 6 krerë:

- Në Kreun I të këtij projektvendimi parashikohen dispozita të përgjithshme, ku përcaktohet koncepti i planit të menaxhimit, si dokumenti bazë për një menaxhim sa më efektiv të pasurisë kulturore publike. Përmes planit të menaxhimit realizohet procesi i planifikimit, bashkërendimit të kompetencave të aktorëve që veprojnë në pasurinë kulturore, me qëllim minimizimin e rreziqeve për pasurinë kulturore, optimizimin dhe gëzimin e saj duke ofruar kushte për akses, informim, ruajtje dhe mbrojtje.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "*Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme*"

Qëllimi parësor i planit të menaxhimit është të propozojë një model efektiv dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e pasurisë kulturore përmes hartimit dhe zbatimit të strategjive dhe udhëzimeve për menaxhimin e vlerave kulturore. Mbrojtjen e pasurisë kulturore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Administrimin efektiv të burimeve financiare si dhe përcaktimin e një strukture administrative funksionale me staf të kualifikuar për menaxhimin e pasurisë kulturore.

Në këtë kre parashikohet gjithashtu se Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe/ose në bashkëpunim me institucionet e specializuara harton planet e menaxhimit proces që drejtohet dhe bashkërendohet nga Instituti Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore (IKTK).

Plani i menaxhimit hartohen nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me propozim/kërkesë nga partner/investitorë/donatorë, pasi partneri/investitori/donatori është dakordësuar më parë me ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Për pasuritë kulturore të paluajtshme, në pronësi të subjekteve private, apo në administrim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, iniciativa për përgatitjen e planit të menaxhimit i takon këtyre të fundit, të cilët e përcjellin në strukturat përkatëse të ministrisë përgjegjëse për kulturën.

- Në **Kreun II** të këtij projektvendimi parashikohet shtrirja në kohë e planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme në funksion të përmbushjes me cilësi të objektivave të planit, të cilat mund të jenë afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë. Kohëzgjatja e planit të menaxhimit nuk mund të jetë më pak se 5 vjet, me qëllim bashkërendimin në mënyrë efikase të burimeve të pasurisë kulturore në shërbim të përmbushjes së objektivave të planit për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.
- Në **Kreun III** të këtij projektvendimi parashikohet struktura dhe përmbajtja e planit të menaxhimit të pasurisë kulturore të paluajtshme. Struktura e planit të menaxhimit përmban; përmbledhjen ekzekutive në të cilën paraqitet shkurtimisht vizioni, qëllimi i planit të menaxhimit, objektivat, përmbajtja, dhe aktivitetet kryesore që parashikohen të kryhen për periudhën kohore të vlefshmërisë së planit. Hyrjen, në të cilën paraqitet shkurtimisht nevoja për planin e ri të menaxhimit, metodologjia e përgatitjes, konsultimet e kryera me palët e interesuara, praktikat më të mira, analiza e legjislacionit në fuqi. Përshkrimin e hollësishëm të pasurisë kulturore, vlerat, gjendja e konservimit të tyre, karakteristikat, integriteti, autenticiteti, kufijtë, koordinatat gjeografike, të dhëna hartografike. Vlerësimin e vlerave kulturore, vlerave të jashtëzakonshme universale (nëse pasuria është pjesë e listës së Trashëgimisë

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme"

Botërore të UNESCO-s). Aspekte të tjera të lidhura me pasurinë, si aspekte të zhvillimit social-ekonomik të komunitetit në dhe përreth pasurisë, turizmin, infrastrukturën dhe çështje të tjera të lidhura me pasurinë. Vizionin, qëllimin, objektivat, ku parashtrohet në mënyrë të përmbledhur ruajtja dhe zhvillimi i pasurisë për një periudhë më të gjatë se afati i planit të menaxhimit në raport me strategjitë kombëtare. Administrimin, ku analizohen në mënyrë të detajuar modelet e mundshme për menaxhimin sa më efikas të pasurisë kulturore të paluajtshme, duke propozuar alternativa zgjidhjeje, ndryshime dhe përmirësime të nevojshme. Planin e veprimit, në të cilin paraqiten të gjitha masat dhe veprimet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata me qëllim përmbushjen e objektivave specifike të planit të menaxhimit. Zbatimin dhe monitorimin, në të cilin përfshihen masat dhe indikatorët për monitorimin e zbatimit të planit të menaxhimit dhe përmbushjes së objektivave të tij. Shtojcat, në të cilat përfshihen dokumente plotësuese apo mbështetëse që lidhen me pasurinë kulturore të paluajtshme.

- Në Kreun IV të projektvendimit është parashikuar metodologjia e përgatitjes së planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme. Metodologjia për përgatitjen e planit të menaxhimit për pasuritë kulturore të paluajtshme synon unifikimin e hapave që kërkon përgatitja e planit të menaxhimit, e cila përfshin:
- a) analizë të integruar të pasurisë kulturore të paluajtshme, për të dhënat e terrenit, analizën e vlerave kulturore, rëndësisë, integritetit, autenticitetit dhe të gjendjes së konservimit, në përputhje me kuadrin ligjor si dhe të një analize SËOT të faktorëve që ndikojnë në ruajtjen e integritetit dhe autenticitetin e vlerave.
  - b) hartimin e vizionit, i cili përmban investimin në ruajtjen e vlerave kulturore, modelin e administrimit funksional, bashkëpunimin institucional dhe ndërinstitutional efektiv, për të rritur kapacitetet për të gjeneruar të ardhura dhe për të rritur fuqinë përthithëse të fondeve;
  - c) Planifikimin strategjik, i cili përfshin objektivat për mbrojtjen e vlerave kulturore dhe sigurimin e përfitimeve për shoqërinë, rezultatet e pritshme, objektivat të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe të përcaktuara nga afate kohore;
  - d) planin e veprimit për realizimin e objektivave nëpërmjet veprimeve konkrete dhe specifike, rezultatet e matshme në terma konkretë dhe institucionet përgjegjëse për zbatim;
  - e) monitorimin dhe rishikimin e Planit të Menaxhimit, përmes monitorimit të zbatimit të planit të menaxhimit, indikatorët dhe planet e veprimit të përcaktuar në planin e menaxhimit.

Plani i menaxhimit, në varësi të specifikës së pasurisë kulturore të paluajtshme, hartohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me mbështetjen e institucioneve shtetërore të specializuara, institucioneve shtetërore të specializuara në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm të kontraktuar, subjekteve

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme"

të kontraktuara nga institucionet shtetërore të specializuara, subjekteve të kontraktuara nga partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm.

➤ Në Kreun V të projektvendimit është parashikuar procedura e konsultimit publik, plani i menaxhimit është objekt i konsultimeve publike me institucione qendrore dhe vendore, grupe interesi të identifikuar dhe partnerë/investitorë/donatorë të mundshëm. Pjesë e konsultimit publik i draftit të planit të menaxhimit mund të jenë, por pa u kufizuar institucionet që kanë në pronësi dhe/ose administrojnë pasuritë kulturore, pronarë të ligjshëm, të njohur brenda pasurisë kulturore, strukturat shtetërore/subjektet që janë burime dytësore për menaxhimin e pasurisë kulturore (p.sh. këshillat vendor kompetentë për menaxhimin e zonës së mbrojtur, komuniteti i zonës dhe grupe të tjera të interesuara (biznese, organizata jo-fitimprurëse apo donatorë të mundshëm).

Fazat e diskutimit publik të draftit të planit të menaxhimit përfshin publikimin e draft-planit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike dhe/ose faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe diskutimin në publik të projekt-planit. Kjo procedurë është shumë e rëndësishme pasi palët e interesuara kanë të drejtë të japin mendimet dhe rekomandimet e tyre rreth projektit.

Publikimi i draft-planit të menaxhimit në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, ndjek hapat; ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore publikon në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike palët e interesuara kanë të drejtë të japin mendimet dhe rekomandimet e tyre rreth projektit të paraqitur brenda 20 ditëve pune nga publikimi, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore shqyrton dhe vendos mbi mendimet dhe rekomandimet e paraqitura. Plani i menaxhimit shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar dhe nëse nuk janë pranuar, një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre, në rastin e pasurive me rëndësi universale, draft-plani i menaxhimit i dërgohet për mendim edhe UNESCO-s.

Gjatë periudhës së publikimit sipas pikës draft-plani i menaxhimit i nënshtrohet diskutimit publik, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore i njofton draft-planin e menaxhimit të pasurisë kulturore Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) dhe institucioneve kompetente përkatëse, njësisë së vetëqeverisjes vendore të zonës ku do të zhvillohet plani, si dhe grupeve e palëve të interesuara

Diskusimi publik i draft-planit, menaxhohet nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK), e cila ka nën administrim pasurinë kulturore të paluajtshme, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet pasuria. DRTK-ja cakton datën e zhvillimit të diskutimit publik dhe njofton grupet apo palët e interesuara dhe komunitetin nëpërmjet afishimit

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme"

të njoftimit në zonën që preket nga plani të paktën 20 ditë para zhvillimit të diskutimit. Në njoftim përcaktohen arsyet e nevojshme për hartimin e planit të menaxhimit, si dhe ndikimin që ai do të ketë, afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre. Gjatë zhvillimit të takimit përfaqësuesi i DRTK-së ose i institucionit kompetent përkatës mban procesverbal, në të cilin pasqyrohen të gjitha diskutimet, mendimet dhe rekomandimet e paraqitura. Listë-prezenca firmoset nga të gjithë të pranishmit dhe i bashkëlidhet procesverbalit përkatës.

Mendimet ose rekomandimet, listë-prezenca dhe një kopje e procesverbalit i përcillen ministrisë ose IKTK-së. Në përfundim të procesit ministria ose IKTK-ja harton një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara dhe, në rast të refuzimit të tyre, një përmbledhje të arsyeve të refuzimit.

- Në Kreun VI të projektvendimit parashikohen dispozita kalimtare, të cilat përcaktojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij.

## VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Kulturës dhe të gjithë institucionet publike.

## VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Kulturës, me mbështetjen e Fondacionit Amerikan-Shqiptar për Zhvillim (AADF) dhe konsulentëve ligjorë të jashtëm.

- Bashkërendim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën datë 17.01.2020 ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

- Bashkërendim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën datë 20.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

- Bashkërendim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme"

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën datë 21.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

➤ Bashkërendim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit  
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën datë 20.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, është shprehur parimisht dakord me disa komente mbi këtë projektvendim, të cilat janë marë parasysh dhe janë reflektuar në projektvendim dhe në relacion.

➤ Bashkërendim me Ministrinë e Drejtësisë  
Ministria e Drejtësisë me shkresën datë 21.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, është shprehur me komente mbi këtë projektvendim, të cilat janë marë parasysh dhe janë reflektuar në projektvendim dhe në relacion.

Referuar pikës 2.4 të shkresës sipërcituar theksojmë se ky vendim është një akt i ri i dalë në zbatim të pikës 3, të nenit 46, të ligjit nr. 27/2018, "*Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*", i cili nuk shfuqizon ndonjë akt nënligjor apo dispozitë të akteve nënligjore, për rrjedhojë pika 2 e kreut VI është hequr.

➤ Bashkërendim me Ministrinë e Mbrojtjes  
Ministria e Mbrojtjes me shkresën datë 24.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

➤ Bashkërendim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën datë 24.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

➤ Bashkërendim me Ministrinë e Brendshme  
Ministria e Brendshme, me shkresën datë 24.01.2020, ardhur nëpërmjet sistemit e-akte, shprehet parimisht dakord me projektvendimin.

## VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk sjell asnjë shpenzim për buxhetin e shtetit.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "*Për shtrirjen, strukturën, përmbajtjen, metodologjinë e përgatitjes dhe procedurën e diskutimit publik të planeve të menaxhimit të pasurive kulturore të paluajtshme*"

## IX. HYRJA NË FUQI E PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim do të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Elva Margariti

